



**VENDIM NË LIDHJE ME KËRKESËN
PËR MARRJEN E
MASAVE TË PËRKOHSHME**

Data e miratimit: 24 gusht 2022

Lënda nr. 2021-02

O.L. dhe të tjerë

kundër

EULEX

Teksti i vendimit të miratuar nga Kryesuesja e Panelit më 24 gusht 2022 u redaktua nga shefi i Misionit, duke shfrytëzuar kompetencat e tij sipas planit operacional (OPLAN-i) për misionin e Bashkimit Evropian të sundimit të ligjit në Kosovë. Shefi i Misionit ka konsideruar se teksti origjinal i vendimit mund të ndikoj në efektivitetin operacional të Misionit.



**VENDIM NË LIDHJE ME KËRKESËN
PËR MARRJEN E
MASAVE TË PËRKOZHSHME**

Data e miratimit: 24 gusht 2022

Lënda nr. 2021-02

O.L. dhe të tjerë

kundër

EULEX-it

Kryesuesja e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, në takimin më 24 gusht 2022, në autoritetin e saj sipas rregullës 22 masat e përkohshme të rregullores së punës së Panelit,

Znj. Snježana BOKULIĆ, kryesuese e Panelit

Ndihmuar nga:

Z. Ronald HOOGHIEMSTRA, zyrtar ligjor

Duke shqyrtuar kërkesën e lartpërmendur për marrjen e masave të përkohshme në lidhje me ankesën, të paraqitur në pajtim me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënies të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit të Shqyrtimit të të Drejtave të Njeriut dhe rregulloren e punës së Panelit të ndryshuar për herë të fundit më 11 dhjetor 2019,

Pas shqyrtimit, u vendos si më poshtë:

I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Kjo ankesë është paraqitur nga ankuesi ne emer te tij, bashkëshortes dhe pesë (5) fëmijëve të tij të mitur.
2. Ankesa në këtë rast iu paraqitura fillimisht Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut ("Paneli") përmes komunikimit elektronik më datën 31 maj 2021. Pas marrjes së formularit për aplikim, ankesa u regjistrua më 26 tetor 2021.
3. Me letrën e datës 9 nëntor 2021, Paneli informoi Misionin Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX-i Kosovë ("Misioni") se ky rast ishte regjistruar në Panel.
4. Pas regjistrimit të ankesës, ankuesi ka vazhduar të paraqesë informacione shtesë.

5. Më 23 prill 2022, ankuesi ka paraqitur një kërkesë për marrjen e masave të përkohshme në rastin e tij.

II. IDENTITETI I ANKUESIT

6. Ankuesi në këtë rast kërkoi që identiteti i tij të mos bëhet i ditur për publikun.
7. Pasi shqyrtoi çështjen, në veçanti natyrën e statusit të ankuesit dhe pretendimet që po bëhen, kryesuesja është e bindur që kjo kërkesë duhej miratuar.

III. PËRBËRJA E PANELIT

8. Kryesuesja ka përcaktuar se është e duhur të shqyrtohet kjo kërkesë për marrjen e masave të përkohshme në cilësinë e saj të vetme si kryesuese e Panelit, në përputhje me rregullën 22 të rregullores së punës.

IV. FAKTET

9. Faktet e lëndës siç paraqiten nga ankuesi mund të përmbliidhen si më poshtë.
10. Ankuesi është shtetas i një shteti të ish-Jugosllavisë. Që në moshë të re, ai ishte përfshirë në veprimtari kriminale në vende të ndryshme të ish-Jugosllavisë. Në një moment, ankuesi u njoh për një kërcënim të besueshëm për jetën e tij dhe filloi të kërkonte në mënyrë aktive një formë mbrojtjeje.
11. Në gusht të vitit 2013, ankuesi dhe bashkëshortja e tij nënshkruan një marrëveshje me Programin për Mbrojtjen e Dëshmitarëve i EULEX-it. Bazuar në këtë marrëveshje, ankuesi ofroj dëshmi në një gjykim penal që kryhet nga prokurorët dhe gjykatësit e EULEX-it. Ankuesit nuk ishte lejuar të kishte ndonjë kopje të kësaj marrëveshjeje.
12. Si dëshmitar i mbrojtur, ankuesi së bashku me gruan dhe fëmijën e tij të vogël u transferuan në vende të ndryshme [REDAKTUAR]
13. Midis muajit gusht 2013 dhe prill 2021, ankuesi dhe familja e tij janë zhvendosur në më shumë se [REDAKTUAR] raste, për periudhën kohore që ndryshon nga disa ditë deri në disa vjet. Gjatë kësaj kohe, ankuesi dhe familja e tij ndodheshin në të paktën 10 (dhjetë) vende të ndryshme në dy (2) kontinente të ndryshme. Në raste të veçanta gjatë kësaj kohe, fëmija i dytë dhe i tretë iu kishte lindur ankuesit dhe gruas së tij.
14. Si rezultat i zhvendosjeve të shumta, fëmija i parë i ankuesit humbi afërsisht tetëmbëdhjetë (18) muaj shkollim, ndërsa fëmija i tij i dytë humbi rreth shtatë muaj e gjysmë (7.5) muaj të arsimit shkollor.
15. Në të paktën dy (2) vendet ku ankuesi ishte zhvendosur, ankuesi dhe familja e tij kishin dokumente vendore të banimit [REDAKTUAR] Në vendet e tjera, ankuesi dhe familja e tij nuk kishin dokumente vendore banimi.

16. Në një numër të madh rastesh që nga gushti i vitit 2013, ankuesi ka pranuar vizita të shumta, në adresat e tij të mbrojtura, nga një numër i konsiderueshëm i zyrtarëve të ndryshëm të EULEX-it dhe zyrtarëve të tjerë që kërkonin të merrnin në pyetje për çështje që kanë të bëjnë me krimin e organizuar në ish-Jugosllavi, si dhe për të diskutuar statusin e tij.
17. Më 30 mars 2021, ankuesi nënshkroi një Deklaratë për tërheqje vullnetare nga Programi për Mbrojtjen e Dëshmitarëve i EULEX-it. Ankuesi nuk iu ishte lejuar të kishte ndonjë kopje të këtyre dokumenteve.
18. Ankuesi aktualisht banon me familjen e tij në një vend anëtar të Bashkimit Evropian. Ai aktualisht ka një status vendor rezident banimi nën emrin e tij.
19. Para pak kohësh, gruaja e ankuesit ka lindur binjakë. Dyshohet se, si rezultat i statusit të tij ligjor të papërcaktuar, ankuesi nuk është në gjendje të regjistrojë lindjen e këtyre dy fëmijëve në asnjë vend. Si pasojë, këta fëmijë nuk kanë identitet ligjor.

V. ANKESA

20. Ankuesi pretendon se Programi për Mbrojtjen e Dëshmitarëve i EULEX-it i ka shkatërruar jetën e tij dhe të familjes së tij. Ai pohon se, si pasojë e lëvizjes së vazhdueshme nga vendi në vend gjatë një periudhe prej tetë (8) vjetësh dhe mungesës së një statusi ligjor të qëndrueshëm, as ai dhe as gruaja e tij nuk kanë qenë në gjendje të përqendrohen në një profesion apo të fitojnë një vend pune. Për më tepër, si rezultat i ndryshimeve të vazhdueshme në lidhje me çështjen e banimit, sistemet shkollore dhe gjuhët, ankuesi pohon se fëmijët e tij vuajnë nga trauma të rënda psikologjike, duke përfshirë zhvillimin e një tendence për vetëdëmtim.
21. Ankuesi pretendon se, kur u regjistrua për herë të parë në Programin për Mbrojtjen e Dëshmitarëve i EULEX-it, atij iu tha se do të kishte nevojë të mbrohej vetëm për një (1) ose dy (2) vjet më së shumti dhe pas kësaj do të ishte në gjendje të gëzonte jetë normale familjare. Ai pohon se, po ta kishte ditur në fillim se çfarë do t'i ndodhte në fakt atij dhe familjes së tij, nuk do të kishte pranuar kurrë të merrte pjesë në program. Përveç kësaj, ankuesi pretendon se tani është lënë në një vend ku ai dhe familja e tij mund të jenë në rrezik, për shkak të afërsisë së shumë emigrantëve nga ish-Jugosllavia.
22. Ankuesi pretendon se mënyra se si e ka trajtuar atë dhe familjen e tij Mbrojtja e EULEX-it për Dëshmitarëve, i ka ekspozuar ata ndaj rrezikut serioz për jetën e tyre. Në veçanti, vizitat tepër të shpeshta të EULEX-it dhe zyrtarëve të tjerë e kanë zbuluar atë në komunitetet ku ishte vendosur. Për më tepër, lagjja ku ai u vendos më në fund nuk u verifikua siç duhet dhe ai është në rrezik të vazhdueshëm për t'u zbuluar nga elementë kriminalë të ish-Jugosllavisë. Ankuesi pretendon se EULEX-i ka dështuar në obligimet e veta pozitive për të mbrojtur jetën e tij dhe atë të familjes së tij, në shkelje të nenit 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
23. Ankuesi pretendon se mënyra se si ai dhe familja e tij janë trajtuar nga EULEX-i përbën trajtim çnjerëzor dhe poshtëruës, në shkelje të nenit 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Përveç kësaj, ankuesi pretendon se EULEX-i ka shkelur të drejtat e tij dhe të drejtat e familjes së tij për të gëzuar jetën e tyre private dhe familjare, siç mbrohet nga neni 8 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
24. Ankuesi pretendon se është përpjekur të rregullojë statusin e tij, por se autoritetet vendore dhe konsullata e shtetit të tij, pretendojnë se ai është dëshmitar i mbrojtur i EULEX-it dhe se, për këtë arsye, ata nuk mund ta ndihmojnë atë. Ankuesi nuk ka qenë në gjendje të

marrë qartësi nga EULEX-i nëse ai ende konsiderohet nga EULEX-i dëshmitar i mbrojtur. Për më tepër, ankuesi është i shqetësuar se si autoritetet vendore ashtu edhe autoritetet e tij shtetërore duket se kanë qasje në informacionin në lidhje me të për të cilin ai nuk është në dijeni.

VI. KËRKESË PËR MARRJEN E MASAVE TË PËRKOSSHME

25. Ankuesi pohon se jeta e tij dhe ajo e familjes së tij mund të jenë në rrezik për shkak të afërsisë së emigrantëve nga ish-Jugosllavia në vendndodhjen e tyre të tanishme dhe rrezikut që ai të njihet.

[REDACTED]

26. Ankuesi kërkon që nga EULEX-i të merren masat e përkohshme në mënyrë që ai dhe familja e tij të zhvendosen nga vendi i tyre aktual në një vend më të sigurt brenda të njëjtit shtet anëtar të Bashkimit Evropian, ose ndryshe që EULEX-i të lehtësojë regjistrimin e ankuesit dhe familjes së tij në programin e mbrojtjes së dëshmitarëve të shtetit të tij.

VII. VLERËSIMI I KRYESUESES MBI KËRKESËN PËR MASA TË PËRKOSSHME

27. Kryesuesja kujton rregullën 22 masat e përkohshme të rregullores së punës, të cilat parashohin se,

"1. Paneli ose kur është e përshtatshme kryesuesi, në bazë të kërkesës së një ankuesi, ose sipas gjykimit të tij, mund t'i propozojë ShM-së që një masë të përkohshme që e konsideron të domosdoshme të zbatohet në interes të zhvillimit të duhur të procedurave që janë para tij. Shefi i Misionit do të marrë një vendim.

2. Paneli mund të kërkojë informacion nga ankuesi ose persona të tjerë për çfarëdo çështje që lidhet me zbatimin e ndonjë mase të përkohshme të vendosur nga ShM-ja.

Konsideratat paraprake

28. Para se të shqyrtojë kërkesën për miratimin e masave të përkohshme, kryesuesja duhet të shqyrtojë nëse ankesa bie *prima facie* brenda juridiksionit të Panelit, siç është parashikuar nga Koncepti i Llogaridhënies së EULEX-it i datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, dhe siç është përpunuar më tej në rregulloren e tij të punës.
29. Kryesuesja duhet të shqyrtojë kompetencën e Panelit lidhur me këtë ankesë sipas kësaj renditje: *ratione materiae, ratione personae dhe ratione temporis.*
30. Sipas rregullës 25, paragrafi 1, Paneli mund të shqyrtojë vetëm ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i Kosovë në kryerjen e mandatit të tij ekzekutiv. Mandati i EULEX-it përcaktohet nga Veprimi i Përbashkët i Këshillit 2008/124/CFSP i datës 4 shkurt 2008, siç është ndryshuar me Vendimin e Këshillit 2018/856 të datës 8 qershor 2018, dhe siç përcaktohet më tej në Planin e Operacionit 2021 të EULEX-it. Në këto dokumente, Programi për Mbrojtjen e Dëshmitarëve përcaktohet se i përket funksioneve ekzekutive të EULEX-it.
31. Në masën që ankesa pretendon shkelje të të drejtave të kryera nga Programi për Mbrojtjen e Dëshmitarëve i EULEX-it, ankesa duhet të konsiderohet se bie në kuadër të

juridiksionit të Panelit *ratione materiae*. Në të njëjtën kohë, duke pasur parasysh se ankuesit, si dëshmitarë të mbrojtur, supozohet se kanë hyrë në juridiksionin e Programit të Mbrojtjes së Dëshmitarëve i EULEX-it, dhe se Programi për Mbrojtjen e Dëshmitarëve është një komponent operacional i Misionit, ankesa duhet kuptuar se i drejtohet Misionit, dhe për këtë arsye të hyjë në kompetencën e Panelit *ratione personae*.

32. Kryesuesja vë në dukje se, sipas ankuesit, ai ka qenë pjesë e Programit për Mbrojtjen e Dëshmitarëve të EULEX-it nga gushti i vitit 2013 deri të paktën më 30 prill 2021. Kryesuesja vëren më tej se ankesa në esencë ka filluar më 31 maj 2021 dhe është regjistruar zyrtarisht më 26 tetor 2021, afat kohor i cili bie brenda periudhës së mandatit të EULEX-it. Ndoshta, duke marrë ndërprerjen e dukshme të Programit të Mbrojtjes së Dëshmitarëve si ngjarje e rëndësishme, ankesa mund të kuptohet se ka filluar brenda afatit gjashtë mujor të ngjarjes së ankimuar, siç kërkohet sipas rregullit 25 të rregullores së punës. Për më tepër, ankuesi pretendon se ka informacione që sugjerojnë se pjesëmarrja e tij në Programin për Mbrojtjen e Dëshmitarëve i EULEX-it, në fakt, nuk është ndërprerë asnjëherë.
33. Në këto kushte, kryesuesja konsideron se kjo ankesë bie *prima facie* brenda juridiksionit *ratione materiae*, *ratione personae* dhe *ratione temporis*.
34. Prandaj kryesuesja do të procedojë shqyrtimin e kërkesës së ankuesit për zbatimin e masave të përkohshme.

Lidhur me kërkesën për masa të përkohshme

35. Kryesuesja përmend jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut ("Gjykata") në lidhje me dhënien e masave të përkohshme sipas rregullës 39 të rregullave të saj të Gjykatës. Rregulla 39 *ndër të tjera* parasheh se

"1. Dhoma ose, kur është e përshtatshme, kryetari i seksionit ose një gjyqtar në detyrë i emëruar sipas paragrafit 4 të kësaj rregullore mund, me kërkesë të një pale ose të çfarëdo personi tjetër të interesuar, ose sipas vetë kërkesës së tyre, t'iu tregoj palëve çfarëdo mase të përkohshme që ata konsiderojnë se duhet të zbatohet në interes të palëve ose të zhvillimit të duhur të procedurave. [...]"

36. Në praktikë, Gjykata ka dhënë masa të përkohshme në rastet që përfshinin rrezik të pashmangshëm të dëmit të pariparueshëm ndaj aplikuesit ose për aftësinë e Gjykatës për të shqyrtuar meritat e ankesës. Në gjykimin e saj të 6 shkurtit 2003 (*Mamatkulov dhe Abdurasulovic kundër Turqisë*, Nos. 46827/99 dhe 46951/99), në paragrafin 55, Gjykata përsëriti se,

"Rregulla 39 e Rregullave të Gjykatës fuqizon një Dhomë ose, kur është e përshtatshme, kryetarin e saj, të tregojë masat e përkohshme që ajo konsideron se duhet të merren. Praktika e kaluar tregon se në parim kërkesat për masa të përkohshme sipas rregullës 39 bëhen në rastet kur ekziston ndonjë rrezik i afërt për jetën e aplikantit ose për torturën, trajtimin ose ndëshkimin çnjerëzor apo poshtërues të tij".

37. Gjykata vuri në dukje, për më tepër, në paragrafin 107 se, "[...] treguesit e dhënë nga Gjykata, ashtu si në rastin e tanishëm, sipas rregullës 39 të Rregullave të Gjykatës, e lejojnë atë të kryejë një shqyrtim efektiv të kërkesës dhe të sigurojë që mbrojtja e ofruar nga Konventa të jetë efektive [...]"
38. Rregulla 22 e rregullores së punës së Panelit kufizon fushën e masave të përkohshme ndaj atyre të miratuara vetëm për interes të zhvillimit të duhur të procedurave. Sipas pikëpamjes së kryesueses, një sërë elementesh janë thelbësore për kryerjen e

procedurave, mbi të gjitha ruajtja e jetës së ankuesve me qëllim që ata të jenë në gjendje të marrin pjesë në procedura deri sa të përfundojnë ato. Lidhur me këtë, mbrojtja e të drejtës për jetë të ankuesve është parësore.

39. Duke pasur parasysh se programet e mbrojtjes së dëshmitarëve janë ngritur dhe vënë në dispozicion të dëshmitarëve që kanë nevojë për mbrojtje, objektivi i tyre kryesor duhet të jetë *“të mbrojnë jetën dhe sigurinë personale të dëshmitarëve/bashkëpunëtorëve të drejtësisë dhe njerëzve të afërt me ta, duke synuar në veçanti sigurimin e mbrojtjes dhe mbështetjes së duhur fizike, psikologjike, sociale dhe financiare”*. (Rekomandimi Rec(2005)9 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës në par. 22.)
40. Në rastin e tanishëm, kryesuesja vëren se ankuesi ka paraqitur, në pesë raste të ndryshme nga data 31 maj 2021 deri më 23 prill 2022, se ka rrezik për jetën e tij për shkak të mundësisë për t’u njohur në lagjen e banesës së tij aktuale si pasojë e statusit të tij të kaluar si kriminel dhe dëshmitar i mbrojtur.
41. Kryesuesja nuk është në gjendje të vlerësojë shkallën e rrezikut për jetën e tij apo të anëtarëve të familjes së tij. Megjithatë kryesuesja vë në dukje se vetë qëllimi i një programi të mbrojtjes së dëshmitarëve është të mbrojë jetën e dëshmitarëve dhe anëtarëve të familjes së tyre. Në të vërtetë, nëse nuk do të ekzistonte ndonjë rrezik për jetën e tyre, nuk do të kishte nevojë që në radhë të parë t’i vendosnin ata në një program të mbrojtjes së dëshmitarëve, duke trazuar jetën e ankuesve dhe me një shpenzim të konsiderueshëm për kuletën publike.
42. Kryesuesja kujton se, në lidhje me mbrojtjen e dëshmitarëve, në aktgjykimin e saj në *R.R. dhe të tjerë kundër Hungarisë* (4 dhjetor 2012, nr. 19400/11) Gjykata në mënyrë eksplicite deklaroi se,
- “[...] në zbatimin e rregullave të mbrojtjes së dëshmitarëve në rastin e aplikantëve, autoritetet pranuan në mënyrë implicite se ekzistonte një rrezik serioz për jetën, anëtarët ose lirinë personale të tyre. [...] Duke pasur parasysh natyrën e njohur të konflikteve mafioze dhe pretendimet e pakundërshtueshme të aplikantëve që kërkohen nga qarqet kriminale – një pohim jo i pabesueshëm sipas asaj se aplikuesi i parë është bërë bashkëpunëtor i drejtësisë që mundëson zhbërjen e veprimtarive kriminale të organizuara ndërkombëtarisht – Gjykata pranon se në të vërtetë ekzistonte një kërcënim serioz për jetën e aplikantëve (jo vetëm ndaj gjymtyrëve apo lirisë), atëherë kur fillimisht ishte vendosur masa.”* (Shih par. 30.)
43. Për më tepër, në një numër rastesh, Gjykata ka përsëritur se neni 2, par. 1, i Konventës krijon një obligim ndaj shteteve gjithashtu për të ndërmarrë hapat e duhur për të ruajtur jetën e atyre që janë brenda juridiksionit të tyre që *“mund të nënkuptoj gjithashtu në disa rrethana të mirëpërcaktuara obligim pozitiv ndaj autoriteteve për të marrë masa parandaluese operationale për të mbrojtur një individ, jeta e të cilit është në rrezik nga veprat penale të një individi tjetër”*. (*R.R. dhe të tjerë kundër Hungarisë, op.cit. par. 28; Mastromatteo kundër Italisë, Gjykimi i datës 24 tetor 2002, nr. 37703/97, par. 67*). Ky obligim pozitiv paraqitet aty ku *“autoritetet e dinin ose duhej ta kishin ditur në kohën e ekzistencës së një rreziku real dhe të menjëhershëm për jetën e një individi apo individi të identifikuar për veprat penale të një pale të tretë dhe [...] Ata nuk arritën të merrnin masa brenda kuadrit të kompetencave të tyre, të cilat, gjykuar në mënyrë të arsyeshme, mund të ishte pritur që të shmangnin këtë rrezik”*. (*Osman kundër Mbretërisë së Bashkuar, Gjykimi i datës 28 tetorit 1998, nr. 23452/94, par. 116*).
44. Në këto kushte, kryesuesja konsideron se rreziku për jetën e ankuesit dhe/ose anëtarëve të familjes së tij është real. Duke pasur parasysh se çdo rrezik për jetë mund të rezultojë

në dëm të pariparueshëm për ankuesit, kryesuesja është e detyruar t'i lëshojë këto masa të përkohshme.


45. Kështu, kryesuesja arrin në përfundimin se faktorët e procedurave para Panelit kërkojnë marrjen e masave të përkohshme. Pra kërkesa e ankuesit për marrjen e masave të përkohshme duhet që të miratohet.

PËR KËTO ARSYE, KRYESUESJA

I PROPOZON shefit të Misionit që masat e përkohshme si në vijim të merren, pa paragjykuar pranueshmërinë dhe meritat e ankesës në lidhje me shkeljet e pretenduara të nenit 2, nenit 3 dhe nenit 8 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut;

1. Programi për Mbrojtjen e Dëshmitarëve i EULEX-it duhet të ndërmarrë çfarëdo veprimi të nevojshëm, në përputhje me rrezikun për jetën e ankuesit ose të familjes së tij dhe brenda mandatit të tij, për të garantuar sigurinë e ankuesit dhe familjes së tij. Ky veprim mund të përfshijë, por nuk kufizohet vetëm në:
 - a. Marrjen e masave të menjëhershme për të ruajtur jetën e ankuesit dhe anëtarëve të familjes së tij, duke marrë parasysh në veçanti mirëqenien e fëmijëve;
 - b. Sqarimin e statusit të ankuesit në kuadër të Programit për Mbrojtjen e Dëshmitarëve të EULEX-it në shtetin mikpritës aktual të ankuesit si dhe në vendin e nënshtetësisë së ankuesit.

KËRKON nga shefi i Misionit të raportojë në Panel mbi veprimet që janë ndërmarrë dhe rezultatet e tyre deri më datën 30 shtator 2022.


Snjezana BOKULIĆ
Kryesuese

